



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

**RAPORTI I ZBATIMIT TË REFORMËS SË
ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR 2020:
STRATEGJIA E REFORMËS SË MENAXHIMIT
TË FINANCAVE PUBLIKE (SRMFP) 2016-2020**

MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE
Shtator 2021, Prishtinë, Kosovë

Shkurtesat

AB - Auditimi i Brendshëm
AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit
ASHI – Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BDMS - (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BE - Bashkimi Evropian
BPV – Bruto Produkti Vendor
COSO - (Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission) - Komiteti i Sponsorimit të Organizatave të Komisionit Treadway
DB – Departamenti i Buxhetit
DG NEAR - Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit
DPMBNF - Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Financiar
DIEKP - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DK - Dogana e Kosovës
DMR - Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut
DSHP – Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme
DTP – Departamenti i Tatimit në Pronë
DTI – Departamenti i Teknologjisë Informative
EDI - Sistemi Elektronik i Deklarimit
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar
GFSM 2014 – Manuali i Statistikave Financiare Qeveritare.
GK MFP - Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike
IKSHP – Instituti Kosovar për Shëndetin Publik
IPSAS - (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
KBF - Komisioni për Buxhet dhe Financa
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KMFP- Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KE - Komisioni Evropian
KEF - Këshillin Ekonomik Fiskal
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik
LPP - Ligji për Prokurimin Publik
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF - Ministria e Financave
MFK – Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MFPT - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MFP - Menaxhimi i Financave Publike
MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NJQH – Njësia Qendrore Harmonizuese
NJAB – Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB - Organizatat Buxhetore

OECD/SIGMA (Organisation for Economic Co-operation and Development/Support for Improvement in Governance and Management) - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

PEFA – (Public Expenditure and Financial Accountability) Llogaridhënja e Shpenzimeve dhe Financave Publike

PIP - Programi i Investimeve Publike

PP – Prokurimi Publik

PKV- Plani Kalimtar i Veprimit

PV – Plani i Veprimit

PVV - Pyetësi Vet-Vlerësues

QRK – Qeveria e Republikës së Kosovës

RAP – Reforma e Administratës Publike

RFID - Sistemi i monitorimit doganor

SBS (Sector Budget Support) - Mbështetja Buxhetore Sektoriale

SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës

SKZH – Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

SNKSP - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP

SSP - Subjekteve të Sektorit Publik

TAK – Tatimi në të Ardhura të Korporatave

TAP – Tatimi në të Ardhura personale

TI - Teknologjia Informative

TVSH – Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

UA - Udhëzimit Administrativ

USAID – Agjencia e shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

VNB – Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

ZPS/ZKM - Zyra për Planifikim Strategjik në Zyrën e Kryeministrit

ZKM - Zyra e Kryeministrit

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	2
I. Përmbledhja ekzekutive	5
II. Pasqyra përmbledhëse	8
Tabela 1: Kartela raportuese e zbatimit të Aktiviteteve të SRMFP në 2020.....	10
Tabela 2.- Kartela raportuese e nivelit të rezultateve të indikatorëve për SRMFP në 2020.....	13
III. Shtylla I: Disiplina Fiskale	15
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i parë	17
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dytë	18
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i tretë	19
IV. Shtylla II: Efikasiteti Alokues	20
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i katërt	22
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i pestë	22
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i gjashtë	23
V. Shtylla III: Efikasiteti Operacional	24
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i shtatë	26
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i nëntë	28
VI. Shtylla IV: Çështjet e ndërlidhura të MFP	28
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dhjetë	30
Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dymbëdhjetë	31

I. Përmbledhja ekzekutive

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP 2016-2020) është dokumenti kryesor strategjik i reformave në shtyllën e tretë të RAP – Menaxhimi i Financave Publike. Qeveria e Republikës së Kosovës synon të siguroj një sistem modern të Menaxhimit të Financave Publike (MFP), që është në harmoni me përvojat më të mira ndërkombëtare dhe mundëson funksionimin efikas dhe efektiv të të gjitha fazave të Menaxhimit të Financave Publike. Në vitin 2018 Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike (GKMFP) ka zhvilluar përditësimin afatmesëm të Planit të Veprimit për vitin 2019-2020 për zbatimin e SRMFP 2016-2020. Strategjia është e organizuar rreth 4 shtyllave, që përmbajnë dymbëdhjetë (12) prioritete kyçe të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe njëzetë (20) indikatorë të suksesit. Strategjia e rishikuar përmban gjithsej dyzetënjë (49) aktivitete për të gjitha fushat prioritare¹. Plani i rishikuar i veprimit ishte rezultat i konsultimeve të gjera publike dhe ka qenë i diskutuar me Komisionin Evropian në kuadër të Dialogut për MFP, dhe është përfunduar në vitin 2018². Aktivitetet e rishikuara gjithashtu kanë vlerësimin e ndikimit financiar, dhe gjashtëdhjetë (62) pika të referimit për vitin 2020, për të siguruar përqendrimin në zbatimin e prioriteteve.

Gjatë vitit 2020 ka qenë e planifikuar arritja e gjithsejtë njëzetë (20) indikatorëve. Rezultatet tregojnë se shtatë (7) prej tyre apo 35% janë arritur, derisa trembëdhjetë (13) indikatorët e mbetur apo 65% nuk janë arritur në tërësi. Gjatë vitit 2020, kemi përqindje të lartë të mos arritjes së vlerave të synuara kryesisht për shkak të ndikimit negativ të pandemisë Covid19 në të gjitha sferat e jetës përfshirë edhe MFP, si dhe masave që Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e detyruar t'i ndërmerret me qëllim të luftimit të pandemisë.

Tek shtylla e parë **Disiplina fiskale**, për tri (3) prioritetet e saj raportohet se nuk janë arritur vlerat e synuara për vitin 2020.

Tek prioriteti i parë, saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave, raporti konstaton se shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat e realizuara, ka nën arritje të vlerës së synuar -5% deri +10%, duke arritur vlerën -15.5%. Në vitin 2018 dhe 2019 janë raportuar arritje të vlerave të synuara duke shënuar shmangie prej -2.7% respektivisht -4.0%.

Për më shumë, tek prioriteti i dytë kontrollat efektive të zotimeve, gjatë vitit 2020 raportohet nën arritje e vlerave të synuara për të dy indikatorët. Indikator i parë borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si përqindje e totalit të shpenzimeve, nuk ka arritur vlerën e synuar prej 2%, duke shënuar 4.47%. Ky indikator edhe gjatë vitit 2018 dhe 2019 nuk ka arritur vlerat e synuara, duke shënuar 3.9% respektivisht 3.7%. Ndërsa, indikator i dytë numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare, raportohet se nuk ka arritur vlerën e synuar prej 100.000, duke shënuar vlerën 75,116 deklarues. Ky indikator në vitin 2018 gjithashtu nuk ka arritur vlerën e synuar, ndërsa në vitin 2019 është arritur vlera e synuar duke shënuar 73,164 tatimpagues.

Tek prioriteti i tretë, mbledhja e qëndrueshme e të hyrave, mund të vlerësohet si progres pasi që ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore, edhe pse nuk ka arritur vlerën

¹ Shih: Plani i Rishikuar i Veprimit për periudhën 2019-2020, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1A893E26-1757-44D9-8538-555CE66C202F.pdf>

² Shih: Rishikimi afatmesëm i SRMFP 2016-2020, e disponueshme në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FF8DA146-CB8B-4BFD-8DF5-38A1A6162E35.pdf>

e synuar prej 25%, ka arritur vlerën prej 25.6%, apo vetëm 0.6% më shumë. Ky tregues nuk ka ekzistuar në vitin 2018, kurse në vitin 2019 ka arritur vlerën e synuar duke shënuar 37.0%.

Tek shtylla e dytë, **Efikasiteti alokues**, prioriteti i parë nuk ka arritur vlerat e synuara, ndërsa dy prioritetet tjera, që kanë nga dy indikatorë matës, kanë arritur pjesërisht vlerat e synuara për 2020. *Prioriteti i katërt*, zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve, raportohet se përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të, nuk ka arritur vlerën e synuar prej 5%, duke shënuar 6.02%, që vlerësohet si zhvillim pozitiv krahasuar me shmangien e shënuar në vitin 2018 (8.92%), në vitin 2019 (8.97%) por edhe në vitin bazë (7.15%). Arsyeja kryesore është se gjatë hartimit të KASH-it 2020-2022 kanë qenë të planifikuara 21 Ministri, ndërsa me buxhetin e aprovuar në Mars të vitit 2020 kanë qenë 15 Ministri.

Tek Prioriteti i pestë, besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor, për përqindjen e shmangies së ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit qendror krahasuar me buxhetin e aprovuar të nivelit qendror, raportohet arritja e vlerës së synuar prej 5%. Vlen të theksohet se ky është progres në krahasim me vitet 2018 dhe 2019 kur vlerat e arritura ishin 12.2% respektivisht 13.3%. Ndërsa, për indikatorin e dytë vlera e synuar për numrin e transfereve gjatë vitit fiskal, raportohet nën arritje të vlerës së synuar prej 120 transfereve, duke shënuar 233 transfere, kryesisht shkak i masave të reja për luftimin e pandemisë. Ky indikator gjatë viteve 2018 dhe 2019 ka arritur vlerat e synuara, duke shënuar 78 respektivisht 137 transfere.

Prioriteti i gjashtë, cilësia e informatave të buxhetit kapital, tek indikatorin numri i ri-alokimeve për OB-të të nivelit qendror, raportohet se ka mbi arritje nga vlera e synuar prej 30 ri-alokimeve, duke shënuar vetëm 25 ri-alokime apo 5 më pak se vlera e synuar. Në vitin 2018 është raportuar se është arritur vlera e synuar duke shënuar 21 ri-alokime, kurse në vitin 2019 vlera e synuar nuk është arritur duke shënuar madje 63 ri-alokime. Sa i përket indikatorit të dytë ruajtjes së nivelit të shpenzimeve kapitale të planifikuara në raport me strukturën e shpenzimeve të përgjithshme, raportohet nën arritje nga vlera e synuar 33.5%, duke shënuar vlerën 29%. Si shkak i kësaj raportohet rritja e mirëmbajtjes së projekteve kapitale. Ky indikator nuk ka qenë prezent në vitin 2018 kurse në vitin 2019 është raportuar i arritur duke shënuar vlerën 33.2%.

Tek shtylla e tretë, **Efikasiteti operacional**, kemi dy prioritetet e para që kanë nga një indikatorë të arritur dhe një të pa arritur, ndërsa prioriteti i tretë ka dy indikatorë të pa arritur dhe një të arritur. *Prioriteti i shtatë*, prokurimi publik, tek indikatorin i parë përqindja e përdorimit të Procedurës së negociuar pa publikim, raportohet të ketë nën arritje të vlerës së synuar prej 7%, duke shënuar 11.38%. Kjo kryesisht shkak i pandemisë. Ky indikator në vitin 2018 dhe 2019 është raportuar të ketë arritur vlerën e synuar, duke shënuar 8.18% respektivisht 8.76%. Ndërsa, indikatorin e dytë përqindja vjetore e vlerës së kontraktuar të mallrave dhe shërbimeve nga AQP në krahasim me vlerën e kontraktuar vjetore të mallrave dhe shërbimeve në PP, ka shënuar mbi arritje të vlerës së synuar prej $\geq 12\%$ (vlerë kjo e bartur automatikisht nga Rishikimi i Marrëveshjes së SBS në MFP) duke shënuar 13.34%. Duhet thënë se vlera e paraparë me rastin e rishikimit të SRMFP për këtë indikator ka qenë $\geq 18\%$. Në vitin 2018 nuk është paraparë ky indikator, kurse në vitin 2019 vlera e synuar e këtij indikator është arritur duke shënuar vlerën 15.84%.

Tek Prioriteti i tetë, fuqizimi i auditimit të brendshëm, indikatorin e parë përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar, raportohet se ka arritur vlerën e synuar prej 90%, duke shënuar vlerën prej 100%. Edhe në vitet 2018 dhe 2019 ky indikator ka arritur vlerën e synuar, duke shënuar 90.85% respektivisht 95% të auditorëve të certifikuar. Ndërsa, indikatorin e dytë përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti, raportohet të ketë nën arritje të vlerës së synuar prej 65%, duke shënuar 42.68% të zbatimit të rekomandimeve. Ky indikator raportohet të

mos ketë arritur vlerat e synuara as në vitet 2018 dhe 2019, kur ka shënuar 51.24% respektivisht 51.32%.

Prioriteti i nëntë, fuqizimi i auditimit të jashtëm, tek indikator i parë përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga KMFP, raportohet të mos ketë arritur vlerën e synuar prej 20%, duke shënuar 18%. Në vitin 2018 ky indikator ka arritur vlerën e synuar duke shënuar 22%, ndërsa në vitin 2019 nuk ka arritur vlerën e synuar duke shënuar 12%. Sidoqoftë duhet thënë se ky është ndoshta progresi më i lartë i reformave në MFP duke marrë parasysh natyrën e indikatorit si dhe vlerën bazë që ka qenë 10%. Sa i përket indikatorit të dytë përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga ZKA, raportohet të ketë mbi arritje të vlerës së synuar prej 35%, duke shënuar vlerën 40%. Në vitin 2018 raportohet të mos jetë arritur vlera e synuar duke shënuar 34%, kurse në vitin 2019 raportohet arritje e vlerës së synuar duke shënuar 39%. Dhe sa i përket indikatorit të tretë përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga ZKA, raportohet se nuk është arritur vlera e synuar prej 30%, duke shënuar vlerën prej 34%. Në vitin 2018 ky indikator nuk ka arritur vlerën e synuar duke shënuar 40%, ndërsa në vitin 2019 ka arritur vlerën e synuar duke shënuar 32%.

Shtylla e katërt, **Çështjet e ndërlidhura të MFP**, raportohet se prioriteti i parë dhe i dytë kanë nga një indikator të arritur, ndërsa prioriteti i tretë ka dy indikatorë të pa arritur.

Prioriteti i dhjetë, Përmirësimi i sistemeve të TI, raportohet të ketë arritur numrin e sistemeve të Integruara, duke shënuar 7 sisteme të integruara, dhe ka vazhduar me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e tyre. Ky indikator raportohet i arritur edhe në vitin 2018 dhe 2019. Sistemet e integruara janë si në vijim: , si në vijim: 1. Sistemi i Tatimit ne Pronë; 2. Sistemi i doganave Asycuda; 3. Sistemi i ATK – Sigtas; 4. Sistemi Thesarit SIMFK; 5. Sistemi e buxhetit PIP; 6. Sistemi i buxhetit BDMS; dhe 7. Sistemi i pagave- Payroll;

Prioriteti i njëmbëdhjetë, transparenca për buxhetin, raportohet se indikator i buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së e GFSM 2014, ka arritur vlerën e synuar. Edhe në vitet 2018 dhe 2019 ky indikator raportohet të ketë arritur vlerat e synuara, planifikimin buxhetor sipas GFSM 2014 respektivisht përdorimin e standardit GFSM 2014.

Prioriteti i dymbëdhjetë, ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP, raportohet të mos ketë arritur vlerat e synuara për dy indikatorët. Indikator i numri i programeve të trajnimit për MFP dhe indikator i numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP, nuk kanë arritur vlerat e synuara, për shkak të mos zbatimit të studimit të fizibilitetit, i cili ishte parakusht për arritjen e këtyre dy indikatorëve.

Sfidë kryesore në zbatimin e SRMFP në vitin 2020, është identifikuar ndikimi negativ i pandemisë COVID19 në shumë fusha të MFP si dhe detyrimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarr masa restriktive me qëllim të luftimit të pandemisë. Në fillim të muajit mars të vitit 2020, Ministria e Financave azhurnoi projeksionet makro-fiskale në kuadër të hartimit të Buxhetit për këtë vit. Gjatë kësaj kohe, gjasat e materializimit të skenarit të pandemisë COVID-19 në Kosovë apo të ndikimit të kësaj situatë të sapofilluar në vendet e tjera u konsideruan si një rrezik i mundshëm por nuk u inkorporuan në parashikimet makro-fiskale. Gjithashtu, deri në fillim të muajit mars, Kosova ishte një nga të paktat vendet në rajon dhe në botë që nuk kishte regjistruar asnjë rast të infektimit me COVID-19. Mirëpo, në një periudhë të shkurtër, situata dhe perspektiva ekonomike në Kosovë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Vlerësimet në Buxhetin e rishikuar për të hyrat totale për vitin 2020 parashikonin rënie vjetore prej rreth 5.3%, krahasuar me projeksionet fillestare. Megjithatë, viti 2020 u mbyll me rënie më të theksuar të të hyrave totale me 14.8% (apo 298 mil. euro), krahasuar me projeksionet fillestare të buxhetit për vitin 2020, dhe rënie prej 8.8% krahasuar me vitin 2019.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore totale në vitin 2020 ishin për 5.2% më të ulëta se projeksionet fillestare të paraqitura në ligjin e buxhetit për vitin 2020. Shpenzimet rrjedhëse ishin për 10.6% (174.7 mil. euro) më të larta se planifikimet në buxhetin fillestar. Kjo rritje kryesisht i atribuohet pagesave në kuadër të akomodimit të një sërë masash të pakos emergjente fiskale dhe pakos së rimëkëmbjes ekonomike. Këto pagesa në kuadër të këtyre pakove gjatë vitit 2020 kishin vlerën prej 317 milionë euro. Pjesa më e madhe e pagesave është bërë në kategorinë e shpenzimeve për subvencione dhe transfere me 248 mil. euro.

Për shkak të përkeqësimit të parametrave makrofiskal nga situata e pandemisë globale Covid-19 Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesa për tejkalim të përkohshëm të kufirit të deficitit buxhetor deri në -6.5% të BPV-së dhe ulja e kufirit të bilancit të shfrytëzueshëm bankar deri në 3% të BPV-së. Viti 2020 u mbyll me deficit fiskal prej 5.3% të BPV-së dhe bilanc të shfrytëzueshëm bankar prej 3.4% të BPV-së.

Bruto produkti vendor gjatë vitit 2020 kishte rënie prej 5.3% në terma real, dhe -4% në terma nominal. Kjo rënie i atribuohet kryesisht rënies në eksportin e shërbimeve prej 41% apo 9.7 pikë përqindjeje, kjo për shkak të kufizimeve të lëvizjes dhe mbylljes së kufijve që ndaluan lëvizjen e diasporës. Gjithashtu edhe investimet totale shënuan rënie prej 7.1% apo 2.5 pikë përqindjeje kryesisht si rezultat i pasigurisë pas masave kufizuese për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Konsumi dhe eksporti i mallrave kishte rritje pozitive prej 2.4% dhe 21.7% respektivisht apo shprehur në pikë përqindjeje 2.3 dhe 1.2 respektivisht.

II. Pasqyra përmbledhëse

Gjatë vitit 2020 sidomos pas tremujorit të parë, duhet përmendur ndikimi negativ i Pandemisë Covid19 si në nivelin koordinues institucional ashtu edhe në të gjithë sektorët e sistemit të menaxhimit të financave publike, ku më shumë e ku më pak. Që nga paraqitja e rasteve të para në mars, kanë filluar të zbatohen masat për mbrojtje nga pandemia COVID19, që janë karakterizuar me kufizim të lëvizjes, aktivitetit ekonomik e social.

Raporti vjetor për zbatimin e SRMFP 2016-2020 në vitin 2020 është bazuar në planin e rishikuar të veprimit 2019-2020 dhe në pasaportën e indikatorëve, duke raportuar në nivel të aktiviteteve dhe të indikatorëve. Procesi i përgatitjes së këtij raporti vjetor ka ndjekur procedurat dhe praktikën e rregullta që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) i zbaton në bazë vjetore, Udhëzimin Administrativ (QRK) NR. 07/2018 dhe ka ndjekur Tabelën Unike të Përmbajtjes për raportet vjetore të monitorimit të Strategjive që janë të lidhura me RAP, e cila tabelë është zhvilluar me ndihmën e OECD/SIGMA.

Procesi i hartimit të raportit vjetor ka filluar në tremujorin e parë të vitit 2021, me mbledhjen e të dhënave nga institucionet përgjegjëse në përputhje me planin e veprimit. Konteksti i krijuar me pandemi rezultoi me vështirësi në mbledhjen e të dhënave. Takimet u zhvilluan në raste të domosdoshme bazuar në rekomandimet e IKSHP, kurse komunikimi elektronik nga distanca u përdor më tepër. Kontributet e strukturave përgjegjëse për zbatimin e SRMFP u kompletuan në fund të tremujorit të parë, kështu që në tremujorin e dytë filloi procesi i analizës së dokumenteve, duke përfshirë rishikimin e raporteve dhe materialeve të tjera të pranuar. Në këtë periudhë u zhvilluan konsultimet fizike dhe online në mes të Sekretariatit, përkatësisht DIEKP/MFPT, dhe strukturave kryesore përgjegjëse për secilin nga 12 prioritetet, të përfaqësuara në GK MFP.

Si rezultat i procesit të analizës së të dhënave, u përgatit drafti fillestar tabelar i raportimit, në përputhje me Udhëzuesin për sistemin e monitorimit dhe raportimit të SRMFP në Kosovë dhe udhëzimet e OECD/SIGMA. Kjo ofroi një pasqyrë të përgjithshme të statusit të secilit aktivitet dhe indikator. Hapi i ardhshëm përfshiu plotësimin dhe finalizimin e informatave për të përgatitur Raportin Vjetor Tabelar për vitin 2020, i cili siguroi pamjen e përgjithshme të gjendjes ekzistuese dhe bazën për zhvillimin e raportit narrativ. Gjatë muajit mars kemi filluar njëkohësisht edhe me hartimin e Raportit Vjetor 2020 të zbatimit të indikatorëve variabil të SBS në MFP. Qëllimi i GK MFP ka qenë që të hartoj që të dy raportet vjetore deri në fund të Prillit 2021, siç është paraparë me marrëveshjen e SBS në MFP. Për më shumë GK MFP, për shkak të vonesës me mbështetje teknike, në tremujorin e parë ka filluar edhe me hartimin e PKV 2021 të SRMFP. Qëllimi ka qenë që në bazë të sidave të identifikuara me Raportin vjetor 2020, të hartohet PKV 2021, që do të adresonte për zbatim aktivitetet e papërfunduara deri në vitin 2020.

Përkundër angazhimeve të shumta në sigurimin e mbështetjes me asistencë teknike nga projekti përcjellës i SBS, përkrahja me ekspertizë në monitorim dhe raportim nuk është arritur. Deri më sot, për komponentin e parë të ToR të asistencës teknike, nga projekti kemi vetëm mbështetjen në hartimin e PKV 2021 të SRMFP. Për shkak të situatës aktuale, mungesës së kapaciteteve dhe mungesës së mbështetjes me ekspertizë, raporti narrativ i zbatimit të SRMFP për vitin 2020, pësoi vonesë deri në Shtator 2021. Kjo vonesë ka ndikuar edhe në vonesën në finalizimin e raportit vjetor 2020 për zbatimin e Indikatorëve Variabil për SBS në MFP, i cili përdor pjesën ekzekutive të raportit 2020 të SRMFP për tu përfunduar. Pengesat e lartpërmendura, rrezikojnë vonesën edhe në hartimin e SRMFP 2022-2026, PV 2022-2024, monitorimit dhe raportimit me kohë si dhe përmirësimin të cilësisë së komunikimit institucional dhe me qytetarë të reformave në MFP. Për shkak të rrethanave aktuale, nuk ka qenë e mundur diskutimi i raportit në takimet e rregullta të Dialogut të MFP-së, ku marrin pjesë edhe partnerët zhvillimor dhe OSHC.

Në konsultim me OECD/SIGMA, hartimi i kornizës strategjike të të tre shtyllave të RAP është vendosur të harmonizohet në aspektin kohor, në mënyrë që strategjitë të mbulojnë periudhën e njëjtë kohore 2022-2026. Me këtë rast MFPT ka vendosur që viti 2021 të shërbej për zbatimin e aktiviteteve të pa zbatuara në vitin 2020 shkaku i ndikimit negativ të pandemisë. Kështu në Shkurt 2021 ka filluar hartimi i PKV 2021³, në Maj 2021 është finalizuar dhe në Qershor 2021 Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve e ka aprovuar planin në fjalë.

Për sa i përket kontekstit më të gjerë të zbatimit të veprimeve të planifikuara të reformës në 2020, si rezultat i ndikimit negativ të pandemisë dhe zhvillimeve politike, kryesisht zgjedhjeve të parakohshme dhe formimin e qeverive të reja (dy) gjatë vitit 2020, ka pasur vështirësi në koordinimin dhe mobilizimin si të institucioneve publike ashtu edhe të asistencës teknike. Këto rrethana kanë shkaktuar përqindje të ulët në arritjen e vlerave të synuara si dhe aktiviteteve të planifikuara. Përkundër kësaj, shikuar nga aspekti i ndikimit të reformave në sistemin e MFP, raporti konstaton se ka progres të gjendjes së përgjithshme në të katër shtyllat e MFP (2020), krahasuar me gjendjen bazë në kohën e hartimit të strategjisë (2016). Për shkak të ndikimit të jashtëm, rezultatet në arritjen e vlerave të synuara për vitin 2020 janë si në vijim:

- Nga gjithsej dyzetënëntë (49) aktivitete, tridhjetenjë (31) apo 63% prej tyre janë zbatuar, kurse tetëmbëdhjetë (18) apo 37% nuk janë zbatuar.
- Nga gjithsej njëzetë (20) indikatorë, shtatë (7) apo 35% prej tyre kanë arritur vlerat e synuara, kurse trembëdhjetë (13) apo 65% nuk kanë arritur vlerat e synuara.

³ Publikuar në: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,117>


Duke marr parasysh rrethanat vështirësuese, të krijuara nga pandemia COVID19, Raporti vjetor i SRMFP vlerëson zbatim të kënaqshëm të SRMFP në vitin 2020. Në vijim është tabela e cila paraqet zbatimin apo mos zbatimin e aktiviteteve të SRMFP për vitin 2020, sipas institucioneve bartëse.

Tabela 1: Kartela raportuese e zbatimit të Aktiviteteve të SRMFP në 2020


AKTIVITETI	STATUSI	INSTITUCIONI
Shtylla 1: Disiplina Fiskale		
Prioritet 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave		
1.1 Sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme të njësisë së makroekonomisë.	Zbatuar	DPMBNF
1.2 Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike.	Pa zbatuar	DPMBNF
1.3 Avancimi i modelit Makro-Ekonomik me qëllim të përmirësimit të parashikimit të indikatorëve kryesorë makroekonomik përfshirë edhe të hyrat tatimore.	Zbatuar	DPMBNF
1.4 Adresimi i rekomandimit të Komisionit Evropian nga takimi i dialogut ekonomik dhe financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimorë, 2018, (Shqyrtimi i opsioneve KEF).	Zbatuar	MF
Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve		
2.1 Plotësim ndryshimet legislative dhe zbatimi i Rregulloreve financiare.	Zbatuar	Thesari i Kosovës
2.2 Futja në përdorim e kontabilitetit të keshit të modifikuar në raportim.	Zbatuar	Thesari i Kosovës, DB, NJQH
2.3 Zgjerimi i funksioneve të SIMFK.	Zbatuar	Thesari i Kosovës
2.4 Zbatimi i Ligjit për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike (KBFP).	Zbatuar	NJQH
2.5 Monitorimi i kontrollit të brendshëm në OB.	Zbatuar	NJQH
2.6 Zbatimi i përshkrimit të proceseve dhe standardit unik të menaxhimit të rrezikut.	Pa zbatuar	NJQH
2.7 Hartimi dhe dërgimi për aprovim në Qeveri i Raportit të konsoliduar vjetor për sistemin e KBFP.	Zbatuar	NJQH
2.8 Hartimi i infrastrukturës ligjore për rregullimin e zotimeve tre-vjeçare.	Pa zbatuar	Thesari i Kosovës, DB
Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave		
3.1 Rritja e përmbushjes së deklaramit me kohë.	Zbatuar	ATK
3.2 Vlerësimi automatik i rreziqeve për të mundësuar aprovimin e menjëhershëm dhe pagesën për TVSh të cilat janë me rrezik të ulët.	Pa zbatuar	ATK
3.3 Modernizimi i sistemit të teknologjisë informative.	Pa zbatuar	ATK
3.4 Intensifikimi i aktiviteteve për luftimin e kontrabandës	Zbatuar	DK
3.5 Luftimi i kontrabandimit të mallrave dhe lehtësimi i tregtisë.	Pa zbatuar	DK
3.6 Ngritja e kapaciteteve në DK për mbledhje të qëndrueshme të të hyrave.	Pa zbatuar	DK
3.7 Ngritja e kapaciteteve në Departamentin e Tatimit në Pronë (DTP) në implementimin e Ligjit të ri Nr. 06/L-005 të Tatimit në Pronën e Paluajtshme.	Pa zbatuar	DTP
Shtylla 2: Efikasiteti alokues		
Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)		
4.1 Fuqizimi i kapaciteteve për hartimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor për nismat e reja qeveritare.	Pa zbatuar	DB
4.2 Avancimi i dokumenteve planifikuese (SKZH-Strategji Sektoriale – KASH)	Zbatuar	DB, ZPS/ZKM
4.3 Vlerësimi i ndikimit të politikave të propozuara me ndikim fiskal në të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.	Zbatuar	DPMBNF, DB

Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor		
5.1 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për transferimet – ri-alokimet.	Pa zbatuar	DB
5.2 Hartimi i dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.	Pa zbatuar	DB
Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital		
6.1 Aprovimi i udhëzimit administrativ (UA) për kriteret përzgjedhëse dhe priorizimin e projekteve kapitale.	Pa zbatuar	DB
6.2 Organizimi i trajnimit për sistemin PIP (trajnimi i zyrtarëve të rinj si dhe rifreskimi i njohurive të zyrtarëve ekzistues).	Pa zbatuar	DB
6.3 Aprovimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për definimin e projekteve kapitale.	Pa zbatuar	DB, Thesari i Kosovës
Shtylla 3: Efikasiteti operacional		
Prioriteti 7: Prokurimi Publik		
7.1 Zhvillimi i procedurave të centralizuara.	Zbatuar	AQP
7.2 Fuqizimi i AQP me personelin e nevojshëm dhe ngritja e kapaciteteve profesionale.	Zbatuar	AQP
7.3 Avancimi dhe fuqizimi i sistemit të e-prokurimit në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.	Pa zbatuar	KRPP
7.4 Monitorimi gjithëpërfshirës i ciklit të aktiviteteve të prokurimit publik me qëllim uljen e numrit të aktiviteteve të anuluar.	Zbatuar	KRPP
7.5 Ndryshimet ligjore në sistemin e Prokurimit Publik.	Pa zbatuar	KRPP
7.6 Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit publik në nivel bazik dhe të avancuar.	Zbatuar	KRPP
Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm		
8.1 Harmonizimi i metodologjisë për monitorimin e NjAB me kërkesat e reja të Ligjit për KBFP.	Zbatuar	NJQH
8.2 Monitorimi i Njësive të auditimit të brendshëm	Zbatuar	NJQH
8.3 Hartimi i planit të trajnimit për auditorët e brendshëm dhe organizimi i trajnimeve sipas planit.	Zbatuar	NJQH, IKAP
Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm		
9.1 Ruajtja e pavarësisë institucionale të ZKA-së.	Zbatuar	ZKA
9.2 Avancimi i metodologjisë së auditimit, përmes automatizimit.	Zbatuar	ZKA
9.3 Përditësimi i Udhëzuesit për Auditime të Rregullsisë.	Zbatuar	ZKA
9.4 Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës së auditimit të performancës së ZKA.	Pa zbatuar	ZKA
9.5 Përfshirja e Kuvendit në shqyrtimin e raporteve të Auditimit.	Zbatuar	ZKA
9.6 Mbikëqyrja/Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së.	Zbatuar	Thesari i Kosovës
Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP		
Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI		
10.1 Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse.	Zbatuar	DTI
10.2 Krijimi i qendrës së të dhënave financiare (Disaster Recovery System).	Zbatuar	Thesari i Kosovës
Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin		
11.1 Modifikimi i SIMFK për ta mundur përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFSM 2014.	Zbatuar	Thesari i Kosovës
11.2 Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë.	Zbatuar	Thesari i Kosovës, DB
11.3 Hartimi i Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ).	Zbatuar	DB
11.4 Raportimi i rregullt financiar për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës.	Zbatuar	Thesari i Kosovës
Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP		
12.1 Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.	Pa zbatuar	DIEKP/DSHP

Progresi i zbatimit të aktiviteteve sipas Shtyllave 2020



Progresi i zbatimit të aktiviteteve sipas Prioriteteve 2020



Performanca e Institucioneve përgjegjëse në SRMFP në zbatim të aktiviteteve 2020




Tabela 2.- Kartela raportuese e nivelit të rezultateve të indikatorëve për SRMFP në 2020

INDIKATORI	BAZA	Vlera e synuar 2020	Arritja sipas viteve			Statusi
			2018	2019	2020	
Shtylla 1: Disiplina fiskale						
Prioritet 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave						
1.1. Shmangia e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat e realizuara	-1.10%	-5% to+10%	-2.7%	-4.0%	-15.5% ⁴	(↓)
Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve						
1.2. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	4.3%	2%	3.9%	3.7%	4.47%	(↓)
Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave						
1.3.1 Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	100,000	68,835	73,164	75,116	(↓)
1.3.2 Ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore.	35%	25%	NA ⁵	37.0%	25.6%	
Shtylla 2: Efikasiteti alokues						
Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)						
2.1 Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15 %	5%	8.92%	8.97%	6.02% ⁶	
Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor						
2.2.1 Përqindja e shmangies së ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit qendror krahasuar me buxhetin e aprovuar në nivelit qendror.	-14.90%	5% ⁷	12.2%	13.3%	5.0%	
2.2.2 Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal.	178	120	78	137	233 ⁸	(↓)
Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital						
2.3.1 Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	55	30	21	63	25	(↑)
2.3.2 Ruajtja e nivelit të shpenzimeve kapitale të planifikuara në raport me strukturën e shpenzimeve të përgjithshme.	33.00%	33.50 %	NA	33.2%	29%	(↓)

⁴ Devijimi në mes të hyrave të realizuara dhe të hyrave të planifikuara, në buxhetin e rishikuar shkak i pandemisë, është -3.7%.

⁵ Me rishikim afatmesëm të SRMFP dhe Planin e Veprimit 2019-2020, disa nga indikatorët janë riformuluar apo larguar.

⁶ Përqindja është në total të buxhetit dhe jo mesatarja e devijimit për secilën OB për arsye se buxheti i aprovuar 2020 ka pasur ndryshime të mëdha në strukturën organizative. Zvogëlimi i numrit të ministrive dhe fuzionimi i tyre nga 21 Ministri në 15 Ministri, apo nga 57 OB në 52 OB.


⁷ Në Shtator 2020 është amendamentuar Kontrata e Performancës së Reformës së Sektorit të Menaxhimit të Financave Publike si pasojë e pandemisë COVID-19 (IPA 2017/040 507), Neutralizimin e katër Indikatorëve variabil për vitin 2020 (1,2,3 dhe 4) si dhe rishikimin e synimeve të indikatorit 5 dhe 8. Me rishikim ky është Ind. Variabil i neutralizuar për vitin 2020.

⁸ Nga niveli qendror 134, ndërsa nga niveli komunal 99 transfere.

Shtylla 3: Efikasiteti operacional						
Prioriteti 7: Prokurimi Publik						
3.1.1 Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 %	7%	8.18%	8.76%	11.38%	(↓)
3.1.2. Përqindja vjetore e vlerës së kontraktuar të mallrave dhe shërbimeve nga AQP në krahasim me vlerën e kontraktuar vjetore të mallrave dhe shërbimeve në PP.	12%	≥ 18% ⁹	NA	15.84 %	13.34%	(↑)
Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm						
3.2.1 Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar.	50%	90%	90.85%	95%	100%	(↑)
3.2.2 Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	51%	65 %	51.24%	51.32 %	42.68%	(↓)
Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm						
3.3.1 Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10%	20 %	22%	12%	18%	
3.3.2 Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.	32%	35%	34%	39%	40%	(↑)
3.3.3 Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.	37%	30%	40%	32%	34%	
Shtylla 4: Çështjet e ndërlidhura të MFP						
Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI						
4.1.1 Numri i sistemeve të Integruara.	0	7	7 sisteme	7	7	
4.1.2 Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014.	Nuk ekziston	Standardi GFSM 2014 në përdorim	Planifikimi Buxhetor sipas GFSM 2014	Standardi GFSM 2014 në përdorim	Standardi GFSM 2014 në përdorim	
Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin						
4.2 Numri i programeve të trajnimit për MFP.	N/A	Programe nga fusha e MFP (përcaktohet pas studimit).	NA	Nuk është përfunduar.	0	
Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP						
4.3 Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP.	NA	Zyrtarë të trajnuar në MFP (përcaktohet pas studimit).	0	NA	0	

⁹ Në Shtator 2020 është amenduar Kontrata e Performancës së Reformës së Sektorit të Menaxhimit të Financave Publike si pasojë e pandemisë COVID-19 (IPA 2017/040 507), Neutralizimin e katër Indikatorëve variabil për vitin 2020 (1,2,3 dhe 4) si dhe rishikimin e synimeve të indikatorit 5 dhe 8. Me rishikim të Ind Variabil, vlera e synuar ishte ≥ 12% për 2020.

Progresi në arritjen e vlerave të synuara të indikatorëve për 2020



III. Shtylla I: Disiplina Fiskale

Shtylla e parë e SRMFP synon të krijojë një kornizë të kujdesshme makroekonomike dhe politikë fiskale me qëllim të forcimit të mbikëqyrjes financiare dhe administrimit të rreziqeve fiskale. MFPT edhe gjatë vitit 2020 vazhdoi të punojë në përfundimin e kornizës afatmesme makro-fiskale dhe eliminimin e rrezikut të paragjykimëve në parashikimet e të hyrave. Shtylla e Disiplinës Fiskale përfshinë tre prioritetë që kanë të bëjnë me Saktësinë e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave, Kontrollët efektive të zotimeve, dhe Mbledhjen e qëndrueshme të të hyrave.

Gjatë vitit 2020, gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) aktivitete ishin planifikuar për disiplinën fiskale, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) aktivitete apo 58% ishin zbatuar plotësisht, ndërsa tetë (8) apo 42% nga aktivitetet e mbetura nuk janë zbatuar.

Kjo shtyllë përmban gjithsej katër (4) indikatorë, ku asnjë nga indikatorët nuk është arritur gjatë vitit 2020.

Zbatimi i aktiviteteve në shtyllën e disiplinës fiskale në 2020



Arritja e vlerave të synuara të indikatorëve në disiplinën fiskale në 2020



Në prioritetin e parë, saktësia e parashikimit të treguesve makroekonomikë dhe të të hyrave, përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia, është arritur të ruhet stabiliteti makroekonomik.

Ky prioritet përmban një (1) indikatorë, i cili nuk është realizuar. Indikatori lidhur me Shmangia e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat e realizuara është -15.5%, kryesisht për shkak të ndikimit negativ të pandemisë dhe masave kufizuese në ekonomi të imponuara nga pandemia.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej katër (4) aktivitete, tre (3) apo 75% ishin zbatuar plotësisht ndërsa një (1) aktivitet apo 25% nuk është zbatuar. Gjatë dy muajve të parë të vitit 2020 kemi pasur një trend mjaft pozitiv të mbledhjes së të hyrave tatimore. Nga 233 mil. euro sa ishin planifikuar të mbledhen gjatë kësaj periudhe, janë mbledhur 248.3 mil.euro që do të thotë 6.6% më shumë të hyra tatimore sesa planifikimi për këtë periudhë. Por, pas paraqitjes së rasteve të para me COVID-19 dhe masave të marra nga Qeveria e Kosovës, situata ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Të hyrat tatimore për vitin 2020 me ligjin e buxhetit janë parashikuar të jenë 1,783 mil. euro¹⁰, gjatë vitit 2020 të hyrat tatimore kanë arritur vlerën 1,506.98 mil. euro¹¹, që do të thotë devijim prej -15.5%. Mirëpo, ndikimi i pandemisë në ekonomi si dhe akomodimi i masave të ndërmarra nga Qeveria për ta zbutur sadopak ndikimin negativ të pandemisë e ka shtyrë Qeverinë e Republikës së Kosovës që të bëjë rishikimin e buxhetit për vitin 2020¹². Të hyrat tatimore me rishikim të buxhetit për vitin 2020 janë planifikuar të jenë 1,565 mil. euro, që krahasuar me realizimin paraqesin devijim prej -3.7%, që është brenda qëllimit të planifikuar për 2020.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, në fillim të vitit janë mbajtur trajnime nga projekti “Mbështetja për Zyrën e Planifikimit Strategjik” të financuar nga Komisioni Evropian, mirëpo pas mbylljes për shkak të pandemisë trajnimet janë ndërprerë, gjithashtu janë mbajtur trajnime me ekspertin e kontraktuar nga USAID-i, por pas përhapjes së pandemisë dhe masave të ndërmarra nga qeveria për lëvizje të lirë të qytetarëve trajnimet janë mbajtur rregullisht në mënyrë virtuale. Me ndihmën e USAID me ekspertizë, është punuar në avancimin e modelit ekzistues të parashikimeve makro-fiskale. Gjithashtu janë bërë avancime në modelin ekzistues për Qëndrueshmërinë e Borxhit si dhe është krijuar modeli për bilancin strukturor. Edhe këtë vit nuk

¹⁰ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/23991BEA-4CD9-40B3-94D3-EA192C572464.pdf>, faqe 25

¹¹ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9AF9DAF3-9623-4315-A468-C14237E94C2E.pdf>, faqe 7

¹² <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9D16BECD-DDF8-4144-BCBB-4CE9945F5CDD.pdf>, faqe 5

ka zhvillime në publikimin e metodologjisë për hartimin e parashikimeve makro-ekonomik. Me qëllim të shqyrtimit të opsioneve për Këshillin Ekonomik Fiskal (KEF), me mbështetje financiare nga Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit (DG NEAR) dhe asistencës teknike të Departamentit për Çështje Fiskale të FMN-së, është hartuar një draft dokument i opsioneve të institucionit të pavarur fiskal.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i parë

Sfidat	Rekomandimet
Pamundësia e ngritjes së kapaciteteve të stafit të njësisë së makroekonomisë, si pasojë e pandemisë.	<ul style="list-style-type: none"> Ngritja e kapaciteteve trajnuese si dhe pajisja me inventar të nevojshëm për trajnime online.
Pasiguria ekonomike në situatat e paparashikuara (sikurse situata e krijuar nga pandemia).	Hartimi i nën-modeleve shtesë të parashikimeve makrofiskale, si dhe analizat e risqeve.

Prioriteti i dytë, kontrolli efektiv i zotimeve, përqendrohet të sigurojë arritjen e vlerës së synuar të uljes së vonesave në pagesa duke rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.

Ky prioritet përmban një (1) indikator, i cili nuk është realizuar. Përkundër përkushtimit për të zvogëluar vonesat në pagesa, nuk është arritur vlera e synuar e indikatorit. Vlen të theksohet se shumica e aktiviteteve të planifikuara janë zbatuar. Indikatori për borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal prej 2% e totalit të shpenzimeve, nuk është arritur 100% pasi që shumica e vonesave në pagesa të raportuara nga OB-të në fund të vitit 2020 ishte në vlerën 104.3 milionë euro, që kur krahasohet me shpenzimet e përgjithshme të vitit 2020 (2.33 miliard euro) jep një rezultat prej 4.47%.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej tetë (8) aktivitete, gjashtë (6) apo 75% ishin zbatuar plotësisht ndërsa dy (2) aktivitete apo 25% nuk janë zbatuar. Progres është arritur në aktivitetet lidhur me plotësim ndryshimet legjislative dhe zbatimin e rregulloreve financiare, që raportohet të jenë zbatuar në tërësi. Kjo ka mundësuar certifikimin e shpenzimeve me kohë, falë edhe monitorimit të vazhdueshëm. Po ashtu, është siguruar regjistrimi i transaksioneve në SIMFK në harmoni me rregullat financiare për planin kontabël, duke respektuar kodet ekonomike. Më tutje, është vazhduar me avancimin e përdorimit të kontabilitetit të keshit të modifikuar në raportim, duke respektuar kërkesat e IPSAS për parimin e kesh-it.

Është mundësuar monitorimi i shpenzimeve dhe faturave përmes arkivës elektronike të krijuar në SIMFK për secilin transaksion. Me qëllim të zbatimit të *Ligjit për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike (KBFP)*, është rishikuar dhe aprovuar Pyetësori Vet-Vlerësues (PVV) në shkurt 2020, si dhe janë ngritur kapacitetet e MFK. Vlen të theksohet bashkëpunimi me USAID-in dhe IKAP.

Përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia, gjë që ka sjellë edhe rishikimin e këtij indikatorit variabil në vetëm 5 monitorime, është arritur monitorimi dhe përgatitja e 8 raporteve të monitorimit të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP). Raporti i konsoliduar vjetor për sistemin e KBFP, i bazuar në 101 PVV dhe 86 raporte nga NjAB, është hartuar dhe aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 09.07.2020 (Vendimi nr.7/12) dhe ka dhënë disa rekomandime për SSP për përmirësimin e sistemit të KBFP.

Kërkohe angazhim shtesë në kuadër të zbatimit të përshkrimit të proceseve dhe standardit unik të menaxhimit të rrezikut. Lidhur me këtë, është përgatitur draft doracaku për auditimin e performancës. Po ashtu, me qëllim të zbatimit në praktikë janë zhvilluar edhe dy pilot auditime të

performancës, në komunën e Vushtrrisë dhe Gjilanit. Zhvillimi i pilot auditimeve të performancës ka pasur ngecje për shkak të pandemisë COVID-19. Pas përfundimit të pilot auditimeve, doracaku për auditimin e performancës do të zbatohet në nivel qendror. Përkundër progresit të sistemit SIMFK, i cili mundëson që projektet kapitale të zotohen për 3 vite, kërkohen edhe ndryshime legjislative që buxheti për tre vite të vendoset në SIMFK dhe procesi të përmbushet në plotëni.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dytë

Sfidat	Rekomandimet
Pengesat e pandemisë në plotësimin kualitativ të pyetësorëve dhe raportit vjetor.	Krijimi i parakushteve për plotësim kualitativ të pyetësorëve.
	Ngritja e kapaciteteve përmes përdorimit të trajnimeve online.

Lidhur me prioritetin e tretë, Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave, i cili tregon rëndësinë për të rritur nivelin e mbledhjes së të hyrave nga taksat dhe doganat. Kjo synohet të arrihet përmes rritjes së kapacitetit të administratës tatimore dhe doganore, përmirësimit të pajtueshmërisë së tatimpaguesit, uljes së evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale.

Ky prioritet përmban një (1) indikator, i cili nuk është realizuar. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2020, numri i bizneseve tatimpaguese që kanë deklaruar vullnetarisht të ardhurat e tyre është nën pikën e referimit për vitin 2020 prej 100,000 deklarues, duke shënuar vlerën 75,116 deklarues. Ndërsa, ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore nuk ka arritur vlerën e synuar prej 25%, duke shënuar vlerën 25.6%. Kjo pasi që borxhi tatimor ka arritur vlerën prej 97,563,764 euro ndërsa realizimi i të hyrave tatimore për vitin 2020 ishte 467, 040,000 euro. Duhet theksuar se ky rezultat i arritur në kohë pandemie është më i mirë se baza referuese në fillim të reformave që ka qenë 35%.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej shtatë (7) aktivitete, dy (2) apo 28.5% ishin zbatuar plotësisht ndërsa pesë (5) aktivitete apo 71.5% nuk janë zbatuar. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka shënuar progres duke operacionalizuar njësinë për trajtimin e mos deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë, duke rritur përputhshmërinë e regjistrimit në kohë. Gjatë periudhës raportuese viti 2020 kemi deklarim për tri llojet kryesore të tatimeve TVSH, TAP dhe TAK. Moduli për Menaxhimin dhe trajtimin e mos-deklaruesve është në përdorim. Gjithashtu, është funksionalizuar Njësia për trajtimin e mos-deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë. Nga kjo Njësi janë pastruar gjithsej 3,768 llogari tatimore si për TVSH, TAP dhe TAK.

Shërbimet elektronike kanë shënuar rritje të përdoruesve të sistemit elektronik EDI, ku përveç deklarimeve të bëra kanë shfrytëzuar sistemin edhe për korrigjime të deklarimeve, dërgimin e librave të blerjes dhe shitjes, shkarkimin e vërtetimeve tatimore, shkarkimin e fletëpagesave për pagesë të borxheve, etj.

Është shënuar progres nga ana e Doganës së Kosovës (DK) në intensifikimin e aktiviteteve për luftimin e kontrabandës. Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 7029 kontrolle në pikë kalime kufitare, 8144 ndalesa rrugore dhe 4752 Patrullime.

Lidhur me vlerësimin automatik të rreziqeve për të mundësuar aprovimin e menjëhershëm dhe pagesën për TVSh të cilat janë me rrezik të ulët, përkundër angazhimit të shtuar nuk është arritur pika e referimit. Në fillim të vitit 2020 është nxjerr Rreg. mbi Procedurat e Rimbursimit/Kthimit të Mjeteve si dhe dokumenti i kriterëve të Rimbursimit. Bazuar në këto kriterë, sistemi në mënyrë automatike bënë kategorizimin e bizneseve sipas kategorisë A, B dhe C. Gjithashtu ka filluar të

funksionoj Divizioni i Rimbursimeve i cili merret me trajtimin e të gjitha kërkesave për rimbursim dhe për të gjitha llojet e tatimeve. Gjatë kësaj periudhe, lëndët e rimbursimit janë kryer në përputhje me Rregulloren dhe rekomandimet e FMN-së. Mesatarja e shqyrtimit të rimbursimeve për vitin 2020 është: 22.5 ditë.

Sa i përket ecurisë së *Projektit Modernizimi i Sistemit të TI*, për shkak të kompleksitetit dhe situatës pandemike projekti është duke u realizuar me disa vonesa.

Monitorimi i plotë i lëvizjes dhe transitit të dërgesave, përmes sistemit RFID (sistemi i monitorimit doganor) ka shënuar ngecje si rrjedhojë e situatës së krijuar nga pandemia. Si rezultat tenderimi i këtij projekti ka dështuar disa herë, prandaj ky projekt është pezulluar për këtë vit. Gjithashtu, si rrjedhojë e situatës pandemike plani i trajnimeve nuk ka arritur të zbatohet në plotëni, përkundër mbajtjes së 37 aktivitete trajnuese dhe trajnimit të 219 zyrtarëve doganorë.

Në rënien e të hyrave nga tatimi në pronë ka ndikuar situata e krijuar nga pandemia Covid-19. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar të hyra në shumë prej 22,700,454.00 euro, apo një rënie prej 4,572,182.00 euro (16.76%).

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i tretë

Sfidat	Rekomandimet
Rritja e përmbushjes tatimore nga ana e tatimpaguesve në situatë pandemie.	Zbatimi i Planit të komunikimit me tatimpagues me qëllim të informimit të tyre për zbatimin e drejtë të legjislacionit tatimor, gjegjësisht edhe deklarimin dhe pagesën në kohë të tatimeve / kontributeve. Ofrimi i vazhdueshëm i informatave për publikun përmes të gjitha formave mediatike, në bashkëpunim të ngushtë grupet e interesit si: Odat Ekonomike, Komuniteti i Biznesit, Shoqatat e Kontabilitetit, etj.
Mos-përmbushja tatimore në sektorët me rrezik të lartë si: sektori i ndërtimtarisë, sektori i akomodimit dhe shërbimeve ushqimore si dhe punësimi joformal.	Zbatimi i reformës "Përmirësimi i Përmbushjes Tatimore" përfshirë aktivitetet edukuese dhe masat e kontrollit tatimor.
Vështirësitë në grumbullimin e borxhit tatimor.	<ul style="list-style-type: none"> • Mundësimi i pagesës së borxhit përmes marrëveshjeve me këste; • Përgatitja e materialeve informuese për pagesë të borxhit tatimor; • Trajtimi i hershëm i borxhit tatimor të krijuar • Realizimi i masave të forcuara për ndërmarrjet të cilat nuk arrijnë të paguajnë obligimet tatimore me kohë; • Ngritja e kapaciteteve në njësinë e menaxhimit të borxhit.
Vonesat në rimbursimin e TVSh-së.	<ul style="list-style-type: none"> • Avancimi i modulit të rrezikut; • Ngritja e kapaciteteve të stafit;


	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi dhe trajtimi i bizneseve të cilat janë në kreditim të TVSh.
Pengesat në funksionalizimin e sistemit të ri TI të ATK-së.	<ul style="list-style-type: none"> • Intensifikimi i aktiviteteve të grupit për menaxhimin e projektit; • Intensifikimi i aktiviteteve të grupit punues i cili është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të përmbushjes dhe kontrollit tatimor; • Ngritja e komunikimit me kompaninë përgjegjëse për modul, me qëllim të reagimit të menjëhershëm për trajtimin e vonesave.
Pamundësia e ngritjes së kapaciteteve për mbledhje të qëndrueshme të të hyrave, si pasojë e pandemisë.	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e kapaciteteve trajnuese dhe pajisjeve për trajnime online. • Përdorimi më i shpeshtë i trajnimeve online.

IV. Shtylla II: Efikasiteti Alokues


Shtylla II synon të sigurojë përdorim efikas dhe efektiv të resurseve të miratuara buxhetore duke forcuar ekzekutimin efikas të buxhetit përmes lidhjes së Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme. Kjo shtyllë përfshin tre prioritete që kanë të bëjnë me rritjen e mëtejshme të rolit të KASH si dokument planifikimi, forcimin e besueshmërisë në buxhetin vjetor dhe menaxhimin më efikas dhe efektiv të investimeve publike.

Gjatë vitit 2020 ishin planifikuar gjithsej tetë (8) aktivitete për efikasitetin e alokimit, ku gjithsej dy (2) apo 25% janë zbatuar, ndërsa gjashtë (6) apo 75% të mbetura nuk janë zbatuar.

Efikasiteti alokues përmban pesë (5) indikatorë, prej të cilëve dy (2) apo 40% janë arritur, ndërsa tre (3) apo 60% nuk janë arritur.



Arritja e vlerave të synuara të indikatorëve në efikasitetin alokues në 2020



Prioriteti i katërt synon të përmirësoj më tutje ndërlidhjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe planifikimin e buxhetit për tre vitet e ardhshme, duke avancuar rolin e KASH si dokument ndërlidhës.

Ky prioritet përmban një (1) indikator, i cili nuk është realizuar. Indikatorin “Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të” është 6.02%, me çka nuk është arritur vlera e synuar prej 5%. Ky krahasim është në total të buxhetit dhe jo mesatarja e devijimit për secilën Organizatë Buxhetore, për arsye se buxheti i aprovuar 2020 ka pasur ndryshime të mëdha në strukturën organizative për shkak të reduktimit të numrit të ministrive dhe fuzionimit të tyre. Gjatë hartimit të KASH -it 2020-2022 kanë qenë të planifikuara 21 Ministri ndërsa me buxhetin e aprovuar në Mars të vitit 2020 kanë qenë 15 Ministri. Rrjedhimisht nga 57 Organizata Buxhetore të nivelit qendror, sa kanë qenë të planifikuara me KASH 2020-2022, në buxhetin e aprovuar për vitin 2020 numri i Organizatave Buxhetore ka rënë në 52 OB.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej tre (3) aktivitete, dy (2) apo 67% ishin zbatuar plotësisht ndërsa një (1) aktivitet apo 33% nuk është zbatuar. Është arritur avancimi i dokumenteve planifikuese duke harmonizuar sektorët e KASH-it me SKZH. Aktualisht OB-të janë të obliguara që në kërkesat e tyre t'i japin prioritet masave dhe aktiviteteve të cilat janë të parapara në SKZH. Është siguruar që OB-të të zbatojnë me përpikëri instruksionet që lëshohen nga MFPT për përgatitjen e KASH, dhe të jenë në harmoni të plotë me SKZH dhe me Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë.

Janë bërë analiza të brendshme për të gjitha iniciativat fiskale që janë ndërmarrë e që kanë pasur ndikim në të hyrat buxhetore. Në opinionet e vlerësimit të ndikimit buxhetor është forcuar mbikëqyrja e deklarimit të kostove nga Buxheti. Me këtë masë sigurohet se është vlerësuar realisht kostoja e paraqitur në formular të VNB-së të iniciativës së OB-së.

Trajnimet për fuqizimin e kapaciteteve për hartimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor për nismat e reja qeveritare nuk janë mbajtur për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, konkretisht nga vendimet për punë të institucioneve me staf të reduktuar dhe kufizimet lidhur me grumbullimet dhe mbajtjen e trajnimeve. Pavarësisht kësaj janë këshilluar së paku 60 zyrtarë për plotësimin e Formularëve të Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i katërt

Sfidat	Rekomandimet
Shmangja në mes të kufirit të KASH-it dhe kufirit vjetor të buxhetit të aprovuar për nivelin qendror, për shkak të ndikimit të pandemisë dhe jo-stabilitetit politik.	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunimi i ngushtë në mes të MFPT dhe Organizatave Buxhetore; Identifikimi i nevojave të domosdoshme për financim; Nevojat e identifikuar konsistente me KASH deri në buxhet të aprovuar.
Pengesat e dala nga pandemia në fuqizimin e kapaciteteve për hartimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor për nismat e reja qeveritare.	Vendosja e trajnimit “Vlerësimi i ndikimit buxhetor për nisma të reja qeveritare” në kalendarin e trajnimeve të IKAP.

Në **prioritetin e pestë** besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor, synohet fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë.

Ky prioritet përmban dy (2) indikatorë, prej të cilëve një (1) është zbatuar. Sa i përket indikatorit që lidhet me përqindjen e devijimit të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në nivelin qendror, është shënuar progres duke arritur vlerën e synuar për periudhën raportuese prej 5%¹³.

Ndërkaq, tek indikatorin “numri i transfereve gjatë vitit fiskal” kemi shmangie të theksuar nga vlera e synuar. Vlera e synuar prej 120 transfere nuk është arritur, duke shënuar vlerën prej 233 transfereve. Gjatë periudhës raportuese kemi 134 transfere nga niveli qendror, ndërsa nga niveli komunal 99 transfere. Rritja e numrit të transfereve ka ndodhur në tremujorin e fundit të vitit 2020, për arsye të shkurtimeve buxhetore të cilat janë bërë me rishikimin e buxhetit për vitin 2020 për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe adresimit të nevojave emergjente të shkaktuar nga kjo pandemi. Transferet janë bërë nga OB me arsyetim të mbulimit të obligimeve ligjore ndaj operatorëve ekonomik.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej dy (2) aktivitete, prej të cilave asnjë nuk është zbatuar. Aktiviteti lidhur me ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Udhëzimit Administrativ (UA) për transferet – ri-alokimet nuk ka arritur vlerën e synuar prej 100 zyrtarëve të trajnuar. Gjatë periudhës raportuese, për shkak të pengesave të dala nga pandemia janë trajnuar gjithsej 70 zyrtarë. Ndërsa, nuk ka pasur aktivitete lidhur me hartimin e dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i pestë

Sfidat	Rekomandimet
Mos-reduktimi i numrit të transfereve gjatë vitit fiskal, për shkak të pandemisë.	Prioritizimi i nevojave të identifikuar dhe të domosdoshme nga OB-të gjatë planifikimit të buxhetit (obligimet kontraktuale).
Mos-hartimi i dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.	Formimi i grupit punues për hartimin e këtij dokumenti.

¹³ Raporti vjetor financiar për vitin 2020, faqe 55, kolona e buxhetit të aprovuar sipas ligjit me Nr 07/L-001 dhe kolona e pagesave (shpenzime) - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27690>

Në prioritetin e gjashtë, synohet një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejtë të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë.

Ky prioritet përmban dy (2) indikatorë, prej të cilëve një (1) është zbatuar. Indikatori në lidhje me numrin e ri- alokimeve për OB-të e nivelit qendror është arritur, duke kaluar vlerën e synuar. Gjatë vitit 2019, numri i ri-alokimeve ishte 25 krahasuar me 55 siç ishte në vitin bazë, si dhe me vlerën e synuar prej 30 ri-alokimeve.

Ndërsa Ruajtja e nivelit të shpenzimeve kapitale të planifikuara në raport me strukturën e shpenzimeve të përgjithshme nuk është arritur. Në vitin 2020 përqindja e pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale në strukturën e buxhetit është 29% me buxhetin e aprovuar në muajin mars të vitit 2020. Kjo përqindje ka qenë më ulët pasi që shpenzimet e mirëmbajtjes së projekteve kapitale janë duke u rritur për çdo vit si rezultat i investimeve të mëhershme publike.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej tre (3) aktivitete, prej të cilave asnjë nuk është zbatuar. Aktiviteti lidhur me ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Udhëzimit Administrativ (UA) për kriteret përzgjedhëse dhe priorizimin e projekteve kapitale nuk ka arritur vlerën e synuar prej 100 zyrtarëve të trajnuar. Gjatë periudhës raportuese, për shkak të pengesave të dala nga pandemia janë trajnuar gjithsej 70 zyrtarë. Me qëllim të tejkalimit të pengesave të dala nga pandemia dhe arritjes së ngritjes së kapaciteteve të duhura, në ueb faqen e MF/DB është lançuar video E-mësimi për financat publike për këtë UA.

Aktiviteti lidhur me ngritjen e kapaciteteve për sistemin PIP nuk ka arritur vlerën e synuar prej 120 zyrtarëve të trajnuar. Megjithatë, përmes IKAP-it janë trajnuar 88 zyrtarë për PIP.

Aktiviteti lidhur me ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Udhëzimit Administrativ (UA) për definimin e projekteve kapitale nuk ka arritur vlerën e synuar prej 100 zyrtarëve të trajnuar. Gjatë periudhës raportuese, për shkak të pengesave të dala nga pandemia janë trajnuar gjithsej 70 zyrtarë. Edhe këtu, me qëllim të tejkalimit të pengesave të dala nga pandemia dhe arritjes së ngritjes së kapaciteteve të duhura, në ueb faqen e MF-DB është lançuar video E-mësimi për financat publike për këtë UA.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i gjashtë

Sfidat	Rekomandimet
Ndikimi i pandemisë në ngritjen e kapaciteteve në zbatimin e UA-ve.	Mbajtja e trajnimeve fizike dhe virtuale sipas kërkesave që paraqiten nga OB-të. Ofrimi i këshillave nga DB në rast të kërkesave nga OB-të.

V. Shtylla III: Efikasiteti Operacional

Shtylla III synon të përforcojë prokurimin publik, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm. Me qëllim të përmirësimit të efikasitetit operacional janë ndërmarrë veprime për të rritur kapacitetet teknike, sistemore dhe njerëzore për realizimin e parimit kryesor në prokurimin publik "vlera për para". Gjithashtu, tek auditimi i brendshëm dhe i jashtëm synohet rregullimi legjislativ, metodologjik, ngritja e kapaciteteve njerëzore si dhe përfshirja e Kuvendit, me qëllim të rritjes së zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Të gjitha këto kanë rezultuar në sigurimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike.

Gjatë vitit 2020, gjithsej 15 aktivitete ishin planifikuar për efikasitetin operacional, dhe dymbëdhjetë (12) apo 80% ishin zbatuar plotësisht, ndërsa tre (3) apo 20% të aktiviteteve të mbetura nuk janë zbatuar.

Kjo shtyllë përmban gjithsej shtatë (7) indikatorë, ku tre (3) indikatorë apo 43% kanë arritur vlerën e synuar, ndërsa katër (4) indikatorë apo 57% e tyre nuk kanë arritur vlerat e synuara.



Prioriteti i shtatë, synon sigurimin e përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimin e parimit kryesor në prokurimin publik "vlera për para".

Ky prioritet përmban dy (2) indikatorë, ku njëri nga indikatorët ka arritur vlerën e synuar ndërsa, tjetri jo. Sa i përket indikatorit të përqindjes vjetore të vlerës së kontraktuar të mallrave dhe

shërbimeve, është arritur vlera e synuar prej 12%¹⁴, duke shënuar vlerën 11.38%. Gjatë vitit 2020 janë nënshkruar 26 kontrata të centralizuara në vlerë prej 38.546,600, që në krahasim me vlerën e kontraktuar vjetore të mallrave dhe shërbimeve në PP në vlerë prej 288,827,429.46 euro, është 13.34% të vlerës së kontraktuar.

Përkundër përkushtimit për të zvogëluar përqindjen e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim, vlera e synuar prej 7% nuk është arritur, pasi që kjo përqindje në vitin 2020 ka mbërritur në 11.38%. Rritja e numrit të përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim, është shkaktuar nga situata e krijuar me pandeminë COVID19.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej gjashtë (6) aktivitete, tre (3) apo 50% ishin zbatuar plotësisht, ndërsa tre (3) aktivitete apo 50% nuk ishin zbatuar.

Të gjitha procedurat dhe metodologjia e re, lidhur me prokurimet e centralizuara janë zbatuar nga AQP. Është zbatuar në tërësi Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/27 të datës 30.04.2020 për listën e artikujve për përdorim të përbashkët.

Kapacitetet profesionale të stafit të AQP-së janë ngritur përmes trajnimeve në fushën e Prokurimit Publik si në nivel bazik ashtu edhe në të avancuar. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese janë rekrutuar tre (3) zyrtarë të prokurimit.

Përmes sistemit të e-prokurimit janë identifikuar 1300 aktivitete të prokurimit të anuluar, janë monitoruar gjithsej 8,537 njoftime të prokurimit të të gjitha llojeve sipas, si dhe është bërë monitorimi i aktiviteteve të 8 rasteve të prokurimit sipas kërkesës nga palët e interesuara, për të cilat janë përpiluar raporte, lëshuar opinione, dhënë rekomandime dhe përgjigje për secilën palë. Gjithashtu janë evidentuar parregullsitë eventuale dhe i janë dhënë rekomandimet autoriteteve kontraktuese për përmirësimet e nevojshme.

Për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia në trajnimin e një numri të madh të përdoruesve, moduli për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të prokurimit elektronik nuk ka filluar të zbatohet gjatë vitit 2020. Pilotimi i veglave dhe teknikave të prokurimit, ankandit dhe ankandit-reversë ose blerjes dinamike në sistem të prokurimit elektronik, nuk është bërë për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Për shkak të vonesave të shkaktuara nga Pandemia Covid19 si dhe nga ndryshimet politike në vend, nuk është arritur të aprovohet Ligji i ri për Prokurimin Publik. Vlen të theksohet se Koncepti Dokumenti për trajtimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik është aprovuar nga Qeveria e Kosovës më dt. 09.09.2020. Pas aprovimit të Konceptit Dokumentit, është themeluar Ekipi përgjegjës për hartimin e Ligjit të ri, dhe me mbështetjen e konsiderueshme të Asistencës Teknike të BE-së në MFP ka finalizuar Draft LPP-në. Nxjerrja e akteve të reja nënligjore për implementim të Ligjit të ri për prokurim publik do të behet brenda periudhës 6 mujore pas aprovimit të ligjit.

Gjithsejtë 223 zyrtarë është dashur që brenda periudhës 3 vjeçare të pajisen me certifikatë të avancuar në fushën e prokurimit publik, si kërkesë ligjore. KRPP në bashkëpunim me IKAP, ka krijuar kushtet për mbajtjen e trajnimeve dhe ka mbajtur trajnimet për të gjithë zyrtarët, të cilët ishin të pajisur me certifikate themelore për prokurim publik dhe të cilët është dashur që të i vijnë trajnimet e nivelit të avancuar gjatë vitit 2020. Gjatë vitit 2020 është mbajtur trajnimi në programin e Avancuar Profesional të prokurimit ku kanë marrë pjesë gjithsejtë 221 zyrtarë, ndërsa prej tyre 177 zyrtarë e kanë arritur kalueshmërinë dhe janë pajisur me certifikatë të Avancuar Profesionale të prokurimit. Dy (2) zyrtarë, edhe pse janë njoftuar, për shkaqe objektive nuk kanë vijuar trajnimet.

¹⁴ Në Shtator 2020 është amandamentuar Kontrata e Performancës së Reformës në Sektorin e Menaxhimit të Financave Publike si pasojë e pandemisë COVID-19 (IPA 2017/040 507), me ç'rast ky indikator është rishikuar. Vlera e synuar prej ≥18% është rishikuar në ≥12%.

Ndërsa, 160 zyrtare, kane vijuar trajnimet dhe janë pajisur me certifikatën themelore Profesionale të prokurimit, e cila është e vlefshme për tre vjet me radhë (2021-2023). Në bashkëpunim me IKAP, janë krijuar kushtet (edhe përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia Covid-19) dhe janë mbajtur trajnimet e nivelit themelor dhe të avancuar në fushën e prokurimit publik. Trajnimet iu janë përshtatur rrethanave të krijuara nga pandemia, duke u mbajtur në formën virtuale (në distancë) përmes platformës elektronike “Skype for Business”.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i shtatë

Sfidat	Rekomandimet
Rritja e numrit të përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.	Vazhdimi i monitorimit të njoftimeve për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë;
Mos zbatimi i Modulit për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të prokurimit elektronik.	Angazhim i shtuar me qëllim të funksionalizimit të modulit për menaxhimin e kontratave përmes sistemit të E-prokurimit publik.
Mos Pilotimi i veglave dhe teknikave të prokurimit, ankandit dhe ankandit-reversë ose blerjes dinamike në sistem të prokurimit elektronik.	Të krijohet baza ligjore për zbatimin e veglave dhe teknikave të prokurimit në sistem të E-prokurimit;
Vonesa në hartimin dhe aprovimin e ligjit të Prokurimit Publik dhe akteve nënligjore	Aprovimi i Ligjit dhe akteve nënligjore të prokurimit publik;
Pamundësia e ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët e prokurimit publik	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e kapaciteteve trajnuese dhe pajisjeve për trajnime online; • Përdorimi më i shpeshtë i trajnimeve online në fushën e prokurimit publik.

Prioriteti i tetë, synon të forcojë disiplinën financiare, kontrollin dhe transparencën përmes Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit të Menaxhimit Financiar të përmirësuar në nivelet qendrore dhe lokale.

Ky prioritet përmban dy (2) indikatorë, me ç’ rast njëri nga indikatorët është përmbushur ndërsa tjetri jo. Vlera e synuar e indikatorit lidhur me përqindjen e auditorëve të brendshëm të certifikuar është arritur, duke rritur numrin e auditorëve të brendshëm të certifikuar në 100%.

Ndërsa, vlera e synuar prej 65% tek indikatorit lidhur me përqindjen e rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti i lartë nuk është arritur, pasi gjatë periudhës raportuese ka 42.68% të rekomandimeve të zbatuara nga menaxhmenti.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej tre (3) aktivitete, ku të tre apo 100% e aktiviteteve janë përmbushur. Është arritur zbatimi i metodologjisë së harmonizuar për monitorimin e NjAB, sipas kërkesave të reja të ligjit për KBFP. Si rezultat, është arritur përmirësimi i cilësisë së auditimit të brendshëm në SSP.

Është arritur aktiviteti lidhur me monitorimin e 10 njësive të auditimit të brendshëm, të cilat janë shoqëruar me rekomandime për përmirësimet.

Vlen të theksohet se është arritur trajnimi i mbi 150 auditorëve të brendshëm. Këtë e ka mundur edhe hartimi dhe zbatimi i planit të trajnimit për auditorët e brendshëm. Përkundër situatës me pandeminë, përkrahja e NjQH nga USAID-i me trajnime gjatë vitit 2020 dhe bashkëpunimi me

IKAP ka ndikuar që të arrihet numër më i madh i auditorëve të trajnuar krahasuar me numrin e planifikuar.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i tetë

Sfidat	Rekomandimet
Mos-zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm.	Angazhimi i shtuar i udhëheqësve të SSP, Komiteteve të Auditimit dhe Auditorëve të Brendshëm.

Prioriteti i nëntë synon zhvillimin e një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht.

Ky prioritet përmban tre indikatorë, ku dy prej tyre nuk kanë arritur vlerën e synuar, kurse një indikatorë është realizuar.

Indikatori lidhur me përqindjen e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike nuk e ka arritur vlerën e synuar prej 20%. Megjithatë kjo shënon një progres të konsiderueshëm kur kihet parasysh se nga baza referuese prej 10% shqyrtimi i raporteve të auditimit nga Kuvendi ka arritur në 18%. Kjo ka rezultuar me shtimin e llogaridhënies në sektorin publik.

Vlera e synuar prej 35% sa i përket rekomandimeve të adresuara dhe të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit është arritur dhe tejkaluar duke arritur vlerën prej 40%.

Ndërsa indikatori, përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për vitin 2020 nuk ka arritur vlerën e synuar prej 30% duke shënuar vlerën prej 34%. Sidoqoftë, duhet thënë se ky indikator ka shënuar përmirësim krahasuar me vitin bazë kur ka qenë 37%.

Gjatë vitit 2020 ishin planifikuar gjithsej gjashtë (6) aktivitete, ku pesë (5) apo 83.3% të aktiviteteve ishin përmbushur, ndërsa një (1) apo 16.7% të aktiviteteve nuk janë realizuar.

Është ruajtur pavarësia institucionale e ZKA-së në linjë me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit. Sistemi informativ i auditimit (SITA) është zhvilluar tërësisht, testuar dhe është futur në përdorim në tetor 2020. Ky sistem është në pronësi të ZKA-së dhe është zhvilluar duke u bazuar në metodologjitë përkatëse të auditimit që i zbaton ZKA-ja. Në veçanti SITA do të lejojë që auditorët në mënyrë të automatizuar të kenë qasje në informacionin e nevojshëm, në një kohë të shkurtër si dhe të përdorin një numër metodash dhe të bëjnë llogaritjet audituese në mënyrë efektive dhe efikase. Ekipet e auditimit kanë ndjekur trajnimet e nevojshme dhe kanë filluar përdorimin e sistemit për sezonën audituese 2020/2021. Ekipi për mbështetje profesionale dhe tavolina ndihmëse për çështjet teknike janë krijuar dhe do t'i ofrojnë mbështetje të plotë auditorëve në rast nevojë. Pjesa dërmuese e aktiviteteve punuese janë zhvilluar në kushte të pandemisë dhe ka qenë mjaft sfiduese për ekipin që një projekt i këtyre përmasave të realizohet suksesshëm përmes punës nga distanca.

Doracaku për auditime të rregullsisë është përditësuar gjatë vitit 2020 dhe tani quhet Doracaku për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Ky përditësim është bërë në pajtueshmëri të plotë me SNISA, bazuar edhe në propozimet për ndryshime të nevojshme dhe me përkrahjen profesionale të projektit të BE të Binjakëzimit. Gjithashtu këtë vit është bërë edhe rishikimi dhe përditësimi i pakos së Letrave të punës, bazuar në kërkesat dhe sipas metodologjisë së re të auditimit.

Përkundër situatës së krijuar me Pandeminë, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vazhduar bashkëpunimin me Kuvendin, respektivisht komisionet parlamentare me qëllim të rritjes së llogaridhënies në sektorin publik. Për këtë qëllim janë mbajtur takime dhe është komunikuar me

Kryetaren e Kuvendit, Kryetarin e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, Kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa si dhe me deputetë e zyrtarë tjerë të Kuvendit sipas nevojës. Edhe pse në kushte të jashtëzakonshme të punës ZKA ka arritur të përfundojë të gjitha auditimet individuale dhe Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2019 të cilat janë dorëzuar në Kuvend brenda afateve të përcaktuara ligjore. Auditori i Përgjithshëm ka prezantuar në seancë plenare këtë raport. Sa i përket shqyrtimit të raporteve individuale të auditimit në komisionet parlamentare, edhe pse në kushte pandemie vërehet një trend pozitiv. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka shqyrtuar gjithsej njëzetekatër (24) raporte të auditimit për organizatat buxhetore dhe Raportin Vjetor të Auditimit për buxhetin e shtetit si dhe Raportin Vjetor të Performancës së ZKA-së. Me qëllim të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së, Thesari ka përgatitur planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dala nga Raporti Vjetor i Auditimit 2019. Ky plan është përgatitur në bazë të inpueteve të dërguara nga OB, gjegjësisht Zyrtarët Kryesor Administrativ të OB-ve. Plani i veprimit është aprovuar në Qeveri dhe është njoftuar Kuvendi dhe Zyra Kombëtare e Auditimit.

Doracakut për auditimet e performancës është në proces të përditësimit, ndërsa gjatë vitit 2020 është përditësuar Pakoja e letrave të punës për auditimet e performancës. Aktiviteti lidhur me 17 raportet e performancës nuk është arritur për shkak të ndikimit që ka pasur pandemia. Ky indikator për auditimet e performancës është vlerësuar të jetë ambicioz andaj nuk reflektohet në planin vjetor të punës për vitin 2020/2021 të ZKA-së. Për këtë arsye janë planifikuar vetëm 8 raporte të auditimit të performancës duke marrë parasysh se mund të ketë situatë të vështirësuar nga pandemia.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i nëntë



Sfidat	Rekomandimet
Vështirësitë në realizimin e auditimeve të performancës, si pasojë e pandemisë.	Përdorimi i metodave alternative për realizimin e auditimeve të performancës.

VI. Shtylla IV: Çështjet e ndërlidhura të MFP

Shtylla e katërt synon përmirësimin e sistemeve të TI-së, transparencën e buxhetit dhe ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme në MFP. Kjo gjithashtu përfshin pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe angazhimin e qytetarëve. Shtylla e katërt, përfshin tre prioritete që lidhen me përmirësimin e sistemeve të TI-së, avancimin e raportimit në përputhje me standardin e FMN-së GFSM 2014 dhe rritjen sistematike dhe të qëndrueshme të kapaciteteve të nëpunësve civilë në MFP.

Gjatë periudhës raportuese ishin planifikuar gjithsej shtatë (7) aktivitete ku gjashtë (6) apo 86% të aktiviteteve janë zbatuar ndërsa një (1) aktivitet apo 14% nuk është zbatuar.

Kjo shtyllë përmban gjithsej katër (4) indikatorë, dy (2) apo 50% prej të cilëve janë arritur, ndërsa dy (2) të mbetur nuk janë arritur.



Prioriteti i dhjetë, synon të përmirësojë sistemet e teknologjisë së informacionit në mënyrë që të përmirësojë menaxhimin e financave publike.

Ky prioritet përmban një (1) indikator, i cili ka arritur vlerën e synuar. Sa i përket përmirësimit të sistemeve të TI-së, është arritur vlera e synuar, ku shtatë (7) sisteme të TI-së janë integruar plotësisht në mes Ministrisë dhe strukturave brenda MFPT-së.

Gjatë vitit 2020, ishin planifikuar gjithsej dy (2) aktivitete, ku të dy aktivitetet apo 100% janë zbatuar. Ka vazhduar mirëmbajtja dhe zhvillimi i sistemit raportues (BI-Bussines Intelegence), Kontrata për integrimin e sistemeve dhe zhvillimin e BI/DWH ka përfunduar në muajin Tetor 2020, ndërsa për vazhdimin e kontratës për mirëmbajtjen dhe avancim do të fillohet sipas procedurave.

Sa i përket krijimit të qendrës së të dhënave financiare (Disaster Recovery System), infrastruktura e TI-së për Disaster Recovery System është konfiguruar në Qendrën e të Dhënave të ASHI-së. Duhet thënë se kjo qendër nuk e plotëson kushtin e distancës së nevojshme (së paku 40 km) nga Qendra e të Dhënave të MFPT.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dhjetë

Sfidat	Rekomandimet
Distanca e pamjaftueshme e Qendrës së të Dhënave Financiare (Disaster Recovery System)	Sigurimi i distancës së mjaftueshme (së paku 40km) nga Qendra e të Dhënave të MFPT.

Në prioritetin e njëmbëdhjetë – synohet sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN/Standardin 2014 GFS.

Ky prioritet përmban një (1) indikator, i cili ka arritur vlerën e synuar. Gjatë vitit 2020, Thesari i mbështetur edhe nga asistenca teknike e FMN ka përgatitur veqlën në harmoni me kërkesat e GFSM 2014 dhe ka publikuar raportin vjetor sipas klasifikimit GFSM 2014. Andaj, nga aspekti i raportimit vlerësohet se është përmbushur objektiva dhe do vazhdohet me publikimin e raporteve vjetore rregullisht.¹⁵ Me rastin e përgatitjes së Buxhetit për vitin 2021, janë sqaruar të gjithë zërat buxhetor në mënyrë që bartja e të dhënave nga Tabela 1 në Pasqyra Financiare të jetë e qartë, konsistente dhe pa gabime. Departamentet përkatëse në MFPT (ish MF - Thesari i Kosovës, Makro, Buxheti) gjatë hartimit të tabelës 1 të ligjit të buxhetit për vitin 2021, janë kujdesur që burimet e financimit të definohen dhe paraqiten në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2021 është bërë konform Ligjit për Financat Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP). Të gjitha ndarjet buxhetore sipas ligjit të buxhetit për vitin 2021 janë regjistruar në SIMFK, në harmoni me LMFPP dhe SNKSP. Gjithashtu gjatë hartimit të raportit vjetor financiar për vitin 2020, Thesari i Kosovës në bashkëpunim me Departamentin për Politika Makroekonomike janë siguruar që të gjithë zërat financiar të jenë në përputhje dhe konform LMFPP dhe SNKSP.

Gjatë periudhës raportuese ishin planifikuar gjithsej katër (4) aktivitete, ku të katër aktivitetet apo 100% janë zbatuar. Sistemi SIMFK është modifikuar dhe mundëson përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFSM 2014, përmes krijimit të skriptës në bashkëpunim me TI-në e Thesarit e cila mundëson që nga Data- Baza në SIMFK të prodhohen raporte kristale në harmoni me klasifikimin GFSM dhe SNKSP.

Thesari ka përditësuar gjatë vitit 2020 planin kontabël sipas kërkesave eventuale për shtim të kodeve ekonomike duke respektuar GFSM 2014.

Është vazhduar me hartimin dhe publikimin online të Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ) për vitin 2020.¹⁶

Ka vazhduar raportimi i rregullt financiar për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës, duke publikuar në baza të rregullta seritë kohore mujore, raportet tremujore dhe raportin vjetor financiar për vitin 2019. Portali i transparencës është funksional dhe janë publikuar të dhënat për ekzekutimin e buxhetit.

Në prioritetin e dymbëdhjetë synohet arritja e një mënyrë sistematike, të qëndrueshme dhe të integruar të ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike, duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.

¹⁵ <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,36>

¹⁶ <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,16>

Ky prioritet përmban dy (2) indikatorë, të cilët nuk kanë arritur vlerën e synuar. Indikatorët e këtij prioriteti nuk kanë arritur vlerë e synuar, përkundër sigurimit të mjeteve financiare për ekzekutimin e studimit të fizibilitetit. Mos-zbatimi i studimit të fizibilitetit ka pamundësuar identifikimin e programeve të trajnimit dhe respektivisht ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e MFP.

Gjatë periudhës raportuese ishte planifikuar një (1) aktivitet, i cili nuk është zbatuar. Aktiviteti-zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime nuk është zbatuar.

Tabela: Sfidat dhe Rekomandimet - Prioriteti i dymbëdhjetë

Sfidat	Rekomandimet
Mungesa e çasjes sistematike në ngritjen së kapaciteteve në fushën e MFP	Realizimi i Studimit të Fizibilitetit